



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 4.2.2019

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROPOZIMIN E EKIPIT PËRZGJEDHËS “PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)”

- *Hyrje*

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 – 36 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e tij të datës 04.02.2019, mori në shqyrtim propozimin e Ekipit Përzgjedhës “Për emërimin e kryetarit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”.

Të pranishëm në mbledhje ishin dy kandidaturat e propozuara nga Ekipi Përzgjedhës, Z. Maksim SHULI dhe Z.Mynyr SINANAJ.

- *Baza ligjore*

Këto kandidatura paraqiten për shqyrtim bazuar në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 11 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar”.

Në bazë të pikës 7 të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni organizon seanca dëgjimore publike në të cilat kandidatët duhet të bëjnë një prezantim të vetes dhe punës së tyre përpara Komisionit.

- *Qëllimi*

Një anëtar i Bordit të ERE-së i përfundon mandati me dt. 6.2.2019. Ekipi Përzgjedhës, në bazë të nenit 11, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me shkresën nr.3922/1 datë 28.12.2018 ka propozuar dy kandidatura për plotësimin e vakancës së krijuar dhe konkretisht kandidaturën e Z. Maksim SHULI i cili rikandidon dhe kandidaturën e Z.Mynyr SINANAJ.

Z.Shuli, ka përfunduar studimet në Fakultetin e Gjeologji Minierave, Dega Inxhinieri e Nxjerrjes dhe Përpunimit të Naftës dhe Gazit në vitin 1982. Z.Shuli është Profesor i Asociuar, ai ka një përvojë të gjatë në fushën e gazit dhe të naftës. Gjithashtu Z.Shuli ka punuar në disa institucione shkencore, ai është anëtar i bordit të Entit Rregullator të Energjisë prej vitit 2014. Z.Shuli një numër të madh botimesh dhe artikujsh shkencorë.

Z.Sinanaj ka përfunduar studimet në Fakultetin e Gjeologji Minierave, Dega Inxhinieri e Nxjerrjes dhe Përpunimit të Naftës dhe Gazit në vitin 1992. Nga viti 1993 deri në vitin 2007 e më pas në vitet 2010 – 2013 ka punuar në pozicione të ndryshme pranë kompanisë Albpetrol sh.a. më tej në vitet 2007 deri 2010 ka punuar si drejtor në Qendrën e Transportit të Naftës dhe Gazit në Patos. Gjithashtu, ka punuar edhe pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Z. Sinanaj ka një eksperiencë 22 vjeçare në fushën e naftës dhe gazit.

- ***Diskutimi në komision***

Komisioni u njoh me CV-të dhe me mendimet e kandidatëve në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë të ERE-së në sektorin e energjisë.

Kandidatët e përzgjedhur paraprakisht nga Ekipi Përzgjedhës Z. Shuli dhe Z. Sinanaj bënë një prezantim të shkurtër të eksperiencave të tyre si dhe një panoramë të sektorit të energjisë dhe sfidave të tij. Meqenëse kjo vakancë i korespondon personit që duhet të mbulojë çështjet e gazit natyror në këtë Bord, ata iu përgjigjën interesit të deputetëve në lidhje me sektorin e gazit dhe perspektivës së përdorimit të tij në vend.

Të dy kandidatët plotësojnë kriteteret e përcaktuara nga neni 11, pika 5/c, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi që kandidaturat e propozuara nga Ekipi Përzgjedhës janë në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Andrea MARTO

Niko PELESHI

Relatori

Kryetari